bortet

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Procedurat dhe Protokollin ... Public Office
Nr. Prot. 05/3219/Do-1654
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages:
Data / Datum / Date: 01.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës

**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**

**Kuvendi - Skupština - Assembly**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **PËR/ZA/TO** | *Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale z.Arban Abrashi* | **DATË DATUM DATE** | **28.02.2017** |
| **NGA/OD/FROM** | *Deputetja Mexhide Mjaku Topalli* M.Topalli | | |
| **SUBJEKTI PREDMET SUBJECT** | **Pyetje për përgjigje me gojë** | | |

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:
I nderuari Ministër:
Para disa muajve është diskutuar për një marrëveshje në mes të MPMS dhe Postës së Kosovës me të cilën posta merr përsipër shpërndarjen e skemave sociale ( ndihmave sociale) në rreth 160 zyra postare, anekënd teritorit të Kosovës. Sindikata e Postës ka treguar se sa do të kursente Qeveria nëse nënshkruhet marrevshja për shpërndarjen e skemave sociale nga bankat private tek posta e Kosovës.

Nëse ndihmat sociale shpërndahen përmes postës e jo nga bankat private kjo do të ishte ne favor dhe e dobishme për Ministrin, Qeverinë dhe përfituesit e ndihmave sociale.

PYETJE :
I nderuari Ministër:
Kur do të fillon të zbatohet shpërndarja e skemave sociale nga zyra e postës në tërë qytetet e Kosovës?

battet

Zyra për Propozime dhe Informime

Nr. Prot.: 05/3247/Do-1668

Data: 07.03.2017

PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

Për: z.Arban Abrashi , Ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Nga: Armend Zemaj - Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Data: 07.03.2017

Lënda: Pyetje Parlamentare

---

Në bazë të nenit 45 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në seancën e radhës së Kuvendit, shtroj këtë pyetje parlamentare për të marrë përgjigje nga Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, z.Arban Abrashi.

**Çështja:**

Qytetarët e Kosovës akoma janë duke u përballë me problemin e mosnjohjes së stazhit të punës nga vitet e okupimit dhe largimit me dhunë nga e drejta legjitime e punës në vitet 1989/1999.

**Pyetja;**

Deri ku ka arritur Ministria që të rregulloj këtë të drejte, për të gjitha ato kategori apo individ të cilëve ju mohohet e drejta për të gëzuar stazhin kontributdhënës që të arrijnë kushtin, "diskriminues" i cili kushtëzohet me 15-të vite të përvojes së punës.

Me respekt,

Armend Zemaj
Deputet i LDK-së në Kuvendin e Republikës së Kosovës

bartet.

Zyra për Propozime dhe Parashtresa - Republic of Kosovo
Nr. Prot. 05/3248/Do-1669
Datum 07.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

Për: z ,Memli Krasniqi, Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Nga: Armend Zemaj - Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Data: 07.03.2017

Lënda: Pyetje Parlamentare

---

Në bazë të nenit 45 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në seancën e radhës së Kuvendit, shtroj këtë pyetje parlamentare për të marrë përgjigje nga Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Memli Krasniqi

**Çështja:**

Në Prill të vitit 2015-të është arritur marrëveshja në mes të Kosovës dhe Komisioni Evropian për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Kosovën, në kuadër të instrumentit të asistencës së para-anëtarësimit IPA-II komponenti i V për zhvillimin rural në Republikën e Kosovës( IPARD).

Duke marre për bazë kohen e kaluar prej dy viteve nga nënshkrimi i kësaj marrëveshje e cila i siguron vendit tonë mjete të konsiderushme financiare, ju drejtohem me;

**Pyetje;**

Deri ku keni arritur me implementimin e obligimeve të marrura si institucione përgjegjëse për të menagjuar këtë asisitence të dobishme financiare, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para zgjerimit (IPA).

Me respekt,

Armend Zemaj
Deputet i LDK-së në Kuvendin e Republikës së Kosovës

bontet

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtreso-Kancelarija za Predloge i Podneske-Table Office
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 05/3299/Do-1694
Nr. i faqeve / Br. strana / No. pages:
Data / Datum / Date: 15-03-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo -Republic of Kosovo
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

| PËR / ZA / TO | Znj. Dhurata Hoxha, Ministre e Drejtësisë | DATË DATUM DATE | 15, Mars 2017 |
|---|---|---|---|
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Time Kadrijaj, Deputete, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

**Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës**

**Pyetja:** Çka është duke ndodhur me të burgosurit "Politik" që nuk po lejohen të kryejnë vizitat mjekësore, kur është në pyetje jeta e tyre. Rasti konkret është me ish komandantin e shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, ish komnadantin e FSK-së, dhe ish ambasadorin e Kosovës në Shqipëri, Z.Sylejman Selimi, i cili që disa vite po mbahet i burgosur padrejtësisht?

D ortiD.

ZYRA PËR PROPOZIME DHE PROCEDURAT E KUVENDIT
Nr. Prot. 05/3304/Do-1670
Nr. i faqeve
Data 17.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **PËR / ZA / TO** | ***Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit z.Kujtim Shala*** | **DATË DATUM DATE** | **16.03.2017** |
| **NGA / OD / FROM** | ***Deputetja Blerta Deliu Kodra*** | | |
| **SUBJEKTI PREDMET SUBJECT** | **Pyetje për përgjigje me gojë** | | |

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:
I nderuari Ministër:
Gjatë vizitës së fundit që e keni pas në Skenderaj keni ofruar mbështetjen e vazhdueshme të projekteve sidomos në projektin e palestrës sportive të këtij qyteti punimet e së cilës ende nuk kanë përfunduar.

PYETJE :
I nderuari Ministër:
Çfarë po bënë ministria që ky projekt të përfundojë dhe sa më shpejt të shfrytëzohet nga qytetarët e Skenderajit?